



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	24.01.2023
REFERENC-Ë:	22/1992/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"DINO MINERAL" SH.P.K. Lipjan Eksplotim i gurit gëlqeror në Koretishtë dhe Strazhë- Novobërdë
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka kontrolluar dokumentacionin për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "DINO MINERAL" SH.P.K. Lipjan, për veprimtarinë: eksploatim i gurit gëlqeror në Strazhë- Novobërdë, me Nr. Prot. 22/1992/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni:

1. Vendimi për Refuzimin e Lejes Mjedisore për operatorin "DINO MINERAL" SH.P.K. Lipjan, për veprimtarinë: eksploatim i gurit gëlqeror Koretishtë dhe Strazhë- Novobërdë.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / РЕПУБЛИКА КОСОВО	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jedinita Org.Unit	SP-02
Nr i Faqeve Br. Stranica No.Pages	- 03-
Nr i Prot. Broj Prot. Prot.No.	1992-2/22
Datë Datum: Date:	02.02.23
PRISHTINË / A	
No. 1	

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, merr Vendim për refuzimin e Lejes Mjedisore ne përputhje me paragrafin 3 te nenit 12, te Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Servet Spahiu

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Novobërdë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti për Mbrojtjes e Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Zaštitu Sredine i Voda / Department of Environment Protection and Waters

REFERENC-Ë:	22/1992/187/MMPHI-DMMU
DATË/A:	24.01.2023
PËR/ZA/TO:	Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ismail Hetemaj, Zëvendësues i Drejtorit të DMMU Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së
NGA/OD/FROM:	Hana Imeri, kryesuese e komisionit për Leje Mjedisore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje lidhur me Leje Mjedisore për operatorin operatorit "DINO MINERAL" SH.P.K. Lipjan Eksplotim i gurit gëlqeror në Koretishtë dhe Strazhë-Novobërdë

Te nderuar,

Bashkëlidhur gjeni lëndën me nr. Protokoli: nr. prot. 22/1992/187/MMPHI-DMMU, të operatorit "DINO MINERAL" SH.P.K. Lipjan, për veprimtarinë: eksploitim i gurit gëlqeror në Koretishtë dhe Strazhë- Novobërdë.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Zivotnu Sredinu i Vodu/
Department of Environment Protection and Water

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENC-Ë:		22/1992/187/MMPHI-DMMU			
PËR/ZA/TO:		Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:		Ismail Hetemaj, Zëvendësues i Drejtorit të DMMU Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së			
NGA/OD/FROM:		Komisioni për Leje Mjedisore			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Përgjigje ne kërkesën e operatorin "DINO MINERAL" SH.P.K. Lipjan Eksplotim i gurit gëlqeror në Koretishtë dhe Strazhë- Novobërdë			
Nr. i zyrës:	1517	Lokacioni:	Ish pallati i mediave	Data:	24.01.2023
Br. kancelarije:		Kucni:	Rilindja, Prishtinë.	Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					☐
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					☒
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					☒
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					☐
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS					☐
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					☐
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					☒
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					☒
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					☒
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					☐
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

I nderuari Sekretar,

Komisionit për Leje Mjedisore i emëruar me Vendimin Nr. 83/2022, me nr. prot. 4306/2022, të dt. 01.08.2022, duke u bazuar në nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, në afatin e paraparë ligjorë, jep këtë Mendim Profesional:

Operatori "DINO MINERAL" SH.P.K. Lipjan, ka aplikuar për tu pajisur me Leje Mjedisore, me Nr. Prot. 22/1992/187/MMPHI-DMMU - për veprimtarinë: eksploatim i gurit gëlqeror në ngastrat kadastrale nr. 205, zona kadastrale Koretishtë dhe ngastra kadastrale nr. 3948 zona kadastrale Strazhë- Novobërdë, sipas Pëlqimit Mjedisor me Nr. 12/2807/2-ZSP/166/13, të lëshuar me dt. 22.07.2013, si dhe Transferit të Pëlqimit Mjedisor me Nr. 21/182/ZSP//21 të lëshuar me dt. 29.01.2021.

Kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 56, datë 19.11.2015, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor ne emër të kompanisë "Rida- Xh Construction" SH.P.K. Gjilan, me Nr. 12/2807/2-ZSP/166/13, të lëshuar me dt. 22.07.2013;
- Komuna Novobërdë- Njoftim se ngastrat kadastrale nuk janë të përfshira në asnjë lloj plani urbanistik në draft planin zhvillimor urban të Komunës së Novobërdës, me nr. 09-08, të lëshuar me dt. 05.01.2021;
- Transfer i Pëlqimit Mjedisor me Nr. 21/182/ZSP//21 të lëshuar me dt. 29.01.2021 nga kompania "Rida- Xh Construction" SH.P.K. Gjilan, ne kompaninë "DINO MINERAL" SH.P.K. Lipjan;
- APK- Pëlqim për lejimin e ndërrimit të destinimit dhe marrje në shfrytëzim të përkohshëm të tokës pyjore me qira, për shfrytëzimin e mineraleve sipërfaqësore, gurit gëlqeror, me nr. KE-119/22, të lëshuar me dt. 31.03.2022;
- KPMM- Licencë për shfrytëzimin e gurit gëlqeror me nr. 281, të lëshuar me dt. 10.20.2014, me afat të vlefshmërisë deri me dt. 13.01.2030;
- Marrëveshje për shitblerjen e gurëthyesit.

Komisioni pas pranimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore, te parashtruar nga kompania ne fjalë, ka njoftuar operatorin me dy shkesa zyrtare përmes e-mailit (e-maili i dt. 06. Shtator 2022, dhe dt. 05 Tetor 2022), për realizimin e vizitave ne teren për verifikimin e kushteve mjedisore, mirëpo përfaqësuesit e kompanisë nuk kanë qenë ne

asnjerën vizitë te pranishëm, ku është pamundësuar verifikimi i kushteve mjedisore nga komisioni për Leje Mjedisore.

Komisioni, në takimin e mbajtur me dt. 13.01.2023, në përbërje prej pesë (5) anëtareve, unanimisht, kanë dhënë mendim profesional si në vijim:

Pasi që operatori nuk ka treguar gatishmëri të mirëpres komisionin në datat e caktuara për vizitë në teren, atëherë, komisioni konsideron që nuk janë plotësuar kushtet e parapara për pajisje me Leje Mjedisore bazuar në paragrafin 2 të nenit 11 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, dhe si rrjedhojë e kësaj, rekomandon që ti refuzohet Leja Mjedisore.

Bashkangjitur këtij Mendimi Profesional gjëni edhe propozim vendimin për refuzimin e Leja Mjedisore.

Komisioni:

Hana Imeri, kryesuese

Adem Tusha, anëtar-

Fatmir Bytyqi, anëtar-

Përparim Terziu, anëtar

Lindita Morina, anëtare

